



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 733/1 Prot.

Tiranë, më 12.05.2025

V E N D I M

Nr. 117, Datë 12.05.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 105, datë 05.05.2025, e paraqitur nga Qendra T'REJA kundër Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet diskriminim i personave që u përkasin pakicave Rome dhe Egjiptiane për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *VKM-ja nr. 843, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit, dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2025, konsiderohet një vendim, zbatimi i të cilit do të sjellë një sërë problemesh tek anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane.*

1. Ka një mungesë të fushatave informuese për qytetarët mbi ndryshimet që sjell kjo VKM, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të marrë nga komisioni i vlerësimit vërtetimin mbi përkatësinë etnike. Deri tani, pakicat rome dhe egjiptiane janë pajisur nga organizatat apo kanë kryer një vetëdeklarim përpara noterit për të aksesuar shërbime të ndryshme. Aktualisht, nuk ka një numër të personave që janë në dijeni të kësaj VKM-je dhe, për më tepër, grupet me të cilat organizata punon nuk kanë asnjë informacion rreth saj.

2. Kohëzgjatja e vlerësimit të formularit të vetëidentifikimit zgjat deri në 30 ditë. Personat që aplikojnë për përjashtimin e pagesës së tarifës së çerdheve, kopshteve të fëmijëve, zakonisht kanë

një afat javor. Si rrjedhojë, rritet risku për të mos përfitur nga kjo e drejtë e njohur me Vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës. E njëjta gjë mund të ndodhë me personat që aplikojnë përgjatë gjithë vitit për përfitimin e programeve sociale të strehimit.

3. Referuar vendimit, mbetet i paqartë afati kohor i vlefshmërisë së vërtetimit të marrë nga komisioni i vlerësimit. Nuk ka informacion dhe të dhëna rreth kohës së cilës ka vlerë të përdoret vërtetimi. Nuk është e parashikuar se si do të veprohet për plotësimin e formularit nga personat të cilët nuk dinë të shkruajnë për shkak të mungesës së arsimit. Për këta persona është e rëndësishme asistencë për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

4. VKM-ja përcakton në pikën 6 se komisioni i vlerësimit mund të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së të dhënave në formularin e vetëdeklarimit. Ju bëjmë me dije se Romët dhe Egjiptianët rezultojnë të regjistruar në Gjendje Civile si “shqiptarë” dhe verifikimi nga ky institucion mund të ndërlikojë më shumë procesin dhe, si pasojë, të sjellë vonesa.

5. Mendojmë se centralizimi i këtij procesi nuk e lehtëson aspak procedurën për pakicat romë dhe egjiptiane. Përkundrazi, rrit më shumë burokracinë dhe riskun për të mos aksesuar shërbimet si pjesë e këtyre dy pakicave.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KMD të ndërhyjë për rekomandimin e për rishikimin e VKM-së për të:

- Ndërmarrë një fushatë informuese tek Njësitë Administrative me qëllim informimin e personave mbi ndryshimet dhe parashikimet e miratuara në vendim.
- Përcaktuar vlefshmërinë afatgjatë të vërtetimit, me të paktën 12 muaj.
- Përcaktimin e personave përgjegjës të cilët do të asistojnë në sqarimin dhe plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.
- Shkurtimin e afatit kohor për vlerësimin e aplikimit nga komisioni i vlerësimit në të paktën 14 ditë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përbërës, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar paraprakisht çështjen dhe ka kostatuar se:

Referuar materialit të vënë në dispozicion, rezulton se pretendimet e paraqitura nga Qendra T'REJA, nuk mbështeten në të dhëna të sakta dhe konkrete. Ankesa përmban vlerësime të përgjithshme dhe shqetësime të natyrës procedurale, pa sjellë asnjë rast specifik, dokumentacion mbështetës apo informacion të verifikueshëm që të provojnë penalizime apo përbërësime të individëve nga përfitimi i të drejtave në zbatim të këtij vendimi. Po ashtu, referuar VKM-së, rezulton se procesi i vetidentifikimit është i ndërtuar mbi respektimin e së drejtës individuale për vetëdeklarim dhe se dispozitat e saj nuk kufizojnë këtë të drejtë, por parashikojnë procedura ndihmëse për funksionimin e procesit. Në këtë kuadër, nuk rezulton që nga zbatimi i këtij vendimi të jenë konstatuar raste penalizimi apo mospranimi të pakicave kombëtare, përfshirë ato rome dhe egjiptiane, çka tregon se pretendimet e ngritura nuk janë të mbështetura në prova faktike.

Referuar përmbajtjes së kërkesës, konstatohet se pretendimet e ngritura lidhur me zbatimin e VKM-së nr. 843, datë 26.12.2024, janë të natyrës supozuese dhe mbështeten në parashikime hipotetike, pa u shoqëruar me fakte konkrete apo raste të dokumentuara që të provojnë efektet negative të përmendura ndaj pakicave rome dhe egjiptiane. Argumentet e paraqitura nuk reflektojnë pasoja reale, por paraqiten si shqetësime të përgjithshme dhe të parakohshme për një

vendim që ka hyrë në fuqi vetëm kohët e fundit dhe që ende nuk ka prodhuar raste penalizimi apo përjashtimi në praktikë. Mungesa e rasteve individuale të dokumentuara, bashkë me faktin që subjekti ankues nuk ka paraqitur të dhëna mbështetëse për të provuar pengesa konkrete në këtë proces, bën që pretendimet të mbeten në kuadrin e hamendësimeve teorike, të cilat nuk mund të shërbejnë si bazë për të vlerësuar se VKM-ja në fjalë cenon të drejtat e këtyre pakicave.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 105, datë 05.05.2025 të paraqitur nga Qendra T’REJA, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA